

NGJITËSIT E PLLAKAVE



STRONGKOLL C2TES1

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë, Gri	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C) me fleksibilitet shumë të lartë (S1), i përbërë nga rërë karbonati dhe mermeri të cilësisë së lartë, rezina sintetike dhe additive specifike, me forcë ngjitëse të përmirësuar (2), rezistent ndaj rrëshkitjes (T) dhe kohë punueshmërie të gjatë (E). Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer dhe fortësi të njëtrajtshme. I klasifikuar si ngjitës C2TES1 sipas standartit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikes në suporte me bazë çimento, gres-porcelanit, klinkerit, mermerit, pllakave të gurit, mozaikëve, pllakave me absorbim të ulët, pllakave me spesor të lartë, për dysheme dhe mure, në ambiente të jashme dhe të brëndshme si dhe mbi shtresa hidroizoluese (p.sh Hidrofix II). I rekomandueshëm për fasada të larta, tarraca, për ambiente me ngrohje qendrore, për ambiente që janë pjesë e vibrimeve, shtypjeve të vazhdueshme, Ideal për pishina, për ambiente industriale, për suporte të valëzuara (kjo si rezultat i elasticitetit dhe deformueshmërisë së lartë). I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione 5-300 cm.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieri 7-8 litra ujë të pastër me 25 kg Strongkoll, përzieri masen e krijuar me një përzierës elektrik deri sa të formohet një masë homogjene dhe pa kokërriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzieri përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë në kushte normale temperaturash (20°C).

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieri 7-7.5 litra ujë të pastër me 25 kg STRONGKOLL, masën e krijuar përziejeni me një përzierës elektrik deri sa të formohet një masë homogjene dhe pa kokërriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziejeni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë në kushte normale temperaturash (20°C).

PËRGATITJA E SUPORTIT

Supportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vavra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të pakten 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit sipërfaqja e suportit duhet të laget në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë me të.





APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përsh-tatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35-40 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe njëherë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyre të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Mbushja e fugave në mure: Pas 8 deri 12 orësh
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Mbushja e fugave në dysHEME: Pas 24 orësh
Ngjyra: E bardhë, Gri	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Konsumi për formate të vogla: 2-3 kg/m ²	Forca ngjitesë pas 28 ditësh: ≥2 N/mm ²
Konsumi për formate të mëdha: 4-5 kg/m ²	FN pas zhytjes në ujë: ≥1.5 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	FN ne nxehtësi: ≥ 2N/mm ²
Masa Vëllimore: 1.6-1.75gr/cm ³	Deformueshmëria: 2.5 mm
Ujë për përzierje: 7-8 litra ujë për 25 kg	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥1.5 N/mm ²
pH i përzierjes: 13	FN pas 30 min: 0.5 N/mm ²
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	Rrëshkitshmëria: ≤0,5 mm
Koha e korigjimit: 35-40 min	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa E



Kujdes! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadëlsim ose përshpejtim në tharje të produktit). Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikoni shttrim të dyfishtë të kollës në pllakë dhe bazament. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitesit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit. Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 3-5 ditë pas ngjites vetëm nëse është bërë hidroizolimi.